



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 347, datë 24.09.2020

PËR

**PËRJASHTIMIN E GJYQTARES {...} NGA LISTA E GJYQTARËVE QË CAKTOHEN
PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË
TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTRON FUNKSIONIN NË MËNYRË TË
PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në paragrafin VIII, pika 6, të Vendimit nr. 30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, pasi shqyrtoi kërkesën dhe materialet bashkëlidhur asaj në lidhje me situatën shëndetësore të gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, znj. {...},

V E N D O S I :

1. Përfshirjen e gjyqtares znj. {...}, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, për një afat 6 (gjashtë) mujor.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR